


Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje, 2022

Tiranë, më 16 Janar 2023: Bazuar në rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit (TIK) gjatë vitit 2022, nga grup-mosha 16 - 74 vjeç, e përdorin internetin 82,6 % e popullsisë, nga të cilët 91,6 % e përdorin disa herë gjatë ditës.

99,9 % e individëve kanë përdorur aparat celularë / telefona inteligjent (smart) për të hyrë në internet. Ndërkohë 23,5 % e popullsisë e përdorin internetin nëpërmjet laptopit, 20,8 % nëpërmjet kompjuter / desktop dhe 13,1 % nëpërmjet tabletit.

98,5 % kryejnë thirrje / video thirrje (përmes Skype, Viber, WhatsApp) dhe ky tregues ka shënuar rritje prej 0,2 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2021.

Fig.1 Pajisjet kryesore të përdorura për të hyrë në internet 2021 - 2022, në %



Familjet me akses në internet

Përqindja e familjeve shqiptare që kanë akses në internet është 96,5 %, krahasuar me 88,3% të një viti më parë. 90,3 % ose 665.362 familje kanë akses në internet me rrjet fiks broadband (rrjet optike ose kabllor, ADSL, etj.), tregues i cili ka shënuar rritje prej rreth 12 pikë përqindje. Përqindja e familjeve me akses në internet nëpërmjet lidhjes “mobile broadband” (3G/4G, tablet, etj.), është 99,2 %, krahasuar me 99,1 % në vitin 2021.

Përdorimi i TIK nga individët e grup-moshës 16 - 74 vjeç


Individët e moshës 16-74 vjeç që kanë përdorur internetin në “tre muajt e fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës, përfaqësojnë 82,6 % të popullsisë në studim. Tregues i cili ka regjistruar një rritje rreth 3,3 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2021. Ndër to, përdoruesit e shpeshtë të internetit përfaqësojnë, 91,6 % të individëve (që përdorin internet disa herë gjatë ditës), ndjekur nga ata që e përdorin çdo ditë me 7,0 % dhe 1,2 % ata që përdorin internetin të paktën një herë në javë.

Nga ana tjetër, aktivitetet që kryhen nëpërmjet internetit në “tre muajt e fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës të cilat kanë regjistruar rritjet më të larta janë: dërgimi / marrja e email-it (11,4 pikë përqindje), për të lexuar lajme online / gazeta apo revista (11,3 pikë përqindje) si dhe pjesëmarrja në konsultime apo votime online për çështje shoqërore apo politike (rreth 10,3 pikë përqindje).

Përdorimi i e-qeverisjes

Në vitin 2022 të gjitha kategoritë për kontaktet elektronike nëpërmjet internetit me autoritetet publike dhe disa shërbime publike, si faqet e internetit në lidhje me detyrimet e qytetarëve (p.sh. deklaratën tatimore, njoftimin për zhvendosje), të drejtat (p.sh. përfitimet sociale), dokumentet zyrtare (p.sh. letërnjoftim, certifikatë të lindjes), shërbimet arsimore publike (p.sh. biblioteka publike, informacion mbi regjistrimin në shkollë ose universitet, shërbimet e shëndetit publik) kanë shënuar rritje. Rritja më e lartë është shënuar për kategorinë “shkarkimi apo printimi e formularëve zyrtarë” me 37,6 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2021 ndjekur nga kategoria “marrje informacioni nga faqet ose aplikacionet e internetit” e cila ka shënuar rritje me rreth 19,3 pikë përqindje.

Fig.2 Përdorimi i e-qeverisjes 2021-2022, në %




Përdorimi i e-blerje (blerje online)

Blerjet “online” i referohen porosive të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet internetit, blerjen e tyre nëpërmjet internetit (e-blerje) për qëllime personale nëpërmjet çdo lloji pajisjeje (desktop, i lëvizshëm ose i dorës, përfshirë telefonin celular ose telefon smart). Blerjet “online” janë kryer nga 34,7 % e popullsisë së grup-moshës 16 - 74 vjeç “në 12 muajt e fundit”, nga momenti i kryerjes së intervistës, tregues i cili ka

shënuar një rritje prej rreth 13,3 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2021. Ndër blerjet “online”, produktet / shërbimet që zënë peshën më të madhe janë rroba / këpucë / aksesorë me 90,8 %, të cilat kanë treguar një rritje nga viti 2021 me 1,9 pikë përqindje.

Në vitin 2022, rritjen më të lartë e kanë shënuar blerjet “online” për “produkte kozmetike/bukurie/mirëqënie” me 18,9 pikë përqindje.

Fig.3 Shpërndarja e individëve për blerjet online, 2021-2022, në %




Aftësitë teknologjike dhe kompjuterike

Në vitin 2022 të gjitha aftësitë teknologjike apo kompjuterike kanë shënuar rritje, ku rritja më e lartë është shënuar për aftësitë lidhur me: “krijimi i prezantimeve” dhe “ndryshimi i opsioneve të një software-i” përkatësisht me 6,0 pikë përqindje dhe rreth 4,8 pikë përqindje.

Për t’u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>

Fig.4 Shpërndarja e individëve sipas aftësive të TIK, 2021-2022, në %



Përdorimi i TIK sipas grup-moshës

Përdorimi i internetit në “tre muajt e fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës tek të rinjtë e moshës 25 - 34 vjeç është 96,8 %. Individët e grup-moshës 65 - 74 vjeç, të cilët kanë deklaruar që nuk e kanë përdorur asnjëherë internetin zënë 36,9 %, tregues i cili është zvogëluar 14,2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021.

Tab.1 Shpërndarja e përdorimit të TIK sipas grup-moshës, 2021-2022, në %

Grup-mosha	Përdoruesit e TIK							
	2021				2022			
	Gjatë 3 muajve të fundit	Midis 3 muajve dhe një viti më parë	Më shumë se 1 vit më parë	Asnjëherë nuk e kam përdorur	Gjatë 3 muajve të fundit	Midis 3 muajve dhe një viti më parë	Më shumë se 1 vit më parë	Asnjëherë nuk e kam përdorur
16-24	96,7	0,4	1,1	1,9	96,5	0,7	0,0	2,8
25-34	94,7	0,5	1,2	3,6	96,8	0,7	0,0	2,4
35-44	88,4	0,3	2,6	8,7	93,4	2,3	0,2	4,1
45-54	78,6	0,9	3,9	16,6	81,9	4,3	2,5	11,3
55-64	64,7	1,1	6,9	27,4	66,9	6,2	4,7	22,1
65-74	40,3	1,4	7,3	51,1	52,2	5,3	5,6	36,9
Gjithsej	79,3	0,8	3,6	16,3	82,6	3,2	2,0	12,2


Përdorimi i internetit në “tre muajt e fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës ka shënuar përqindjet më të larta në kategorinë “disa herë gjatë ditës”, në të gjitha grup-moshat, ku 91,6 % e popullsisë 16 - 74 vjeç e përdorin atë në disa herë në ditë.

Tab.2 Shpërndarja e shpeshtësisë së përdorimit të TIK sipas grup-moshave, 2021-2022, në %

Grup-mosha	Frekuenca e përdorimit							
	2021				2022			
	Disa herë gjatë ditës	Çdo ditë	Të paktën një herë në javë	Më pak se një herë në javë	Disa herë gjatë ditës	Çdo ditë	Të paktën një herë në javë	Më pak se një herë në javë
16-24	96,3	0,9	2,5	0,3	97,0	2,5	0,5	0,0
25-34	95,1	2,3	2,4	0,2	96,8	2,7	0,5	0,0
35-44	89,1	5,0	5,3	0,5	94,6	4,8	0,6	0,0
45-54	81,8	6,4	11,1	0,7	88,2	10,9	0,9	0,0
55-64	76,2	7,7	14,9	1,2	86,3	11,8	1,9	0,0
65-74	61,3	10,2	26,5	2,0	73,7	17,9	5,7	2,6
Gjithsej	87,3	4,4	7,7	0,6	91,6	7,0	1,2	0,2

Përdorimi i internetit “disa herë gjatë ditës” ka regjistruar përqindjet më të larta në grup-moshat 25-34 vjeç ndjekur nga 16-24 vjeç.


Fig.5 Shpërndarja e përdorimit të internetit “disa herë gjatë ditës”, sipas grup-moshave 2022, në %



Nëse do të analizojmë shpërndarjen e individëve që kryejnë thirrje / video thirrje (përmes Skype, Viber, WhatsApp), “gjatë tre muajve të fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës, vihet re se 98,5 % e popullsisë 16-74 vjeç kryejnë thirrje / video thirrje.

Shpërndarja e individëve që kryejnë thirrje / video thirrje (përmes Skype, Viber, WhatsApp) “gjatë tre muajve të fundit” sipas grup-moshave (Fig.6) tregon se grup-mosha 25-34 vjeç ka shënuar përqindjen më të lartë 24,5% ndjekur nga grup-mosha 16-24 vjeç 18,7%.

Fig.6 Shpërndarja e individëve që kryejnë thirrje/video thirrje, sipas grup-moshave, 2022, në %



Përdorimi i TIK sipas gjinisë

Përdorimi i internetit në vitin 2022 si për burrat edhe për gratë shënon vlerat më të larta për kategorinë “gjatë 3 muajve të fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës, duke shënuar rritje prej 3,3 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2021. Gjatë vitit 2022, 83,7 % e burrave dhe 81,5 % e grave të grup-moshës 16 - 74 vjeç janë përdorues të internetit “gjatë 3 muajve të fundit”.

Tab.3 Shpërndarja e përdorimit të TIK sipas gjinisë, 2021-2022, në %

Gjinia	Përdoruesit e TIK							
	2021				2022			
	Gjatë 3 muajve të fundit	Midis 3 muajve dhe një viti më parë	Më shumë se 1 vit më parë	Asnjëherë nuk e kam përdorur	Gjatë 3 muajve të fundit	Midis 3 muajve dhe një viti më parë	Më shumë se 1 vit më parë	Asnjëherë nuk e kam përdorur
Burra	80,3	0,8	3,7	15,2	83,7	3,0	2,0	11,3
Gra	78,3	0,7	3,5	17,4	81,5	3,3	2,1	13,0
Gjithsej	79,3	0,8	3,6	16,3	82,6	3,2	2,0	12,2


Shpeshtësia e përdorimit të internetit sipas ndarjes gjinore, tregon se përdorimi i internetit “disa herë gjatë ditës” dominohet nga burrat me 50,1 %, ndërsa përdorimi i tij “çdo ditë” dominohet nga gratë me 51,5 %.

Tab.4 Shpërndarja e shpeshtësisë së përdorimit të TIK sipas gjinisë, 2022, në %

Gjinia	Frekuenca e përdorimit 2022				Gjithsej
	Disa herë gjatë ditës	Çdo ditë	Të paktën një herë në javë	Më pak se një herë në javë	
Burra	50,1	48,5	54,2	37,9	50,0
Gra	49,9	51,5	45,8	62,1	50,0
Gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0

Sa i përket blerjeve nëpërmjet internetit, sipas gjinisë, gjatë vitit 2022 gratë kanë kryer më shumë blerje për: “produkte për kujdes personal (kozmetikë, etj)”, “produkte shtëpiake” si dhe “produkte për fëmijë apo lodra për ta”. Ndërkohë burrat kanë shfaqur preferenca më shumë në blerjet për: “kompjuter, tableta, celularë ose aksesore të tjerë” dhe “biçikleta, scooter-a, makina dhe pajisje të tyre”.

Fig.7 Blerjet online sipas gjinisë, 2022, në %



Metodologjia

Anketa mbi Përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësisive ekonomike familjare (NjEF) dhe ka objekt të gjithë individët të grup-moshës 16-74 vjeç me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri.

Të dhënat e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje dhe nga Individët do të shërbejnë si një nga inputet për llogaritjen e përdorimit të treguesve mbi teknologjitë e përdorura për informacion dhe komunikim nga familjet dhe individët.

Anketa mbledh të dhëna mbi çështje në lidhje me përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në familje dhe nga individët mbi: pajisjet e familjes për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (telefon, pajisje kompjuterike, akses në Internet), përdorimin e internetit, e-blerjeve, e-qeverisjes, etj. Për të analizuar më shumë aspekte të përdorimit të teknologjive të reja të cilat janë gjithmonë në zhvillim pyetësi është dinamik, kështu që çdo vit shtohen module të reja pyetjesh me periudha të ndryshme reference kohore.

Anketa mbi Përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët u krye për herë të parë në vitin 2018 me një kampion përfaqësues për të gjithë Shqipërinë.

Në vitin 2022, anketa mbi Përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët u krye me një kampion prej 7.200 NjEF. Në përfundim të vrojtimit u intervistuan rreth 4.799 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 66,7 %.

Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. Njësitë e hapit të parë (PSU) janë zonat e Censit të homogjenizuara, me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 10 NjEF. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësishme.

Mbledhja e të dhënave:

Kryhet një interviste direkte nga anketuesit me pyetësor në laptop (metoda CAPI) ku përfshihen pyetje për familjen dhe të dhënat bazë në lidhje me të, si dhe realizohet intervistë individuale për çdo person prezent në NjEF i grup-moshës 16-74 vjeç.

Struktura e pyetësorit:

- Informacion i përgjithshëm;
- Karakteristikat demografike të anëtarëve të NjEF-së;
- Pyetësi Individual (karakteristika socio-demografike, modulet mbi përdorimin e TIK prej tyre).

Përkufizime:

Një njësi ekonomike familjare (NjEF) i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

Periudha e referencës/referuese është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni. Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar. Në vitin 2022 anketa është kryer në periudhën Shtator – Nëntor 2022.

Interneti është sistemi rrjeteve kompjuterike të ndërlidhura që përdorë Suitën e Protokollit të Internetit (TCP/IP) për të lidhur miliarda pajisje në të gjithë botën. Ai është një rrjet i rrjeteve që përbëhet nga miliona rrjete private, publike, akademike, biznese, dhe qeveritare, me fushëveprim lokal deri në global, të lidhura nga një koleksion i gjerë elektronik, wireless, dhe teknologjitë e rrjeteve optike. Interneti mbart një gamë të gjerë të burimeve të informacionit dhe shërbimeve, të tilla si dokumentet e ndërlidhura hypertext dhe aplikacionet e World Wide Web (www), posta elektronike, telefonia dhe rrjetet peer-to-peer për file sharing.

Akses i referohet qasjes në internet jo vetëm në shtëpi por a mund anëtarët e familjes t'a aksesojnë atë kur /ku të duan.

Shërbimi me Internet Broadband është forma më e përdorur e qasjes në internet për shkak të shpejtësisë së lartë; ajo ofrohet në disa forma të ndryshme, DSL, ADSL gjithashtu fibra optike, kabllor dhe satelit, rrjete WiFi publike, përmes antenës.